



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES KOMEMORATIVE ME RASTIN E VDEKJES SË DEPUTETES
NEKIBE KELMENDI, TË MBAJTUR MË 20 QERSHOR 2011**

**SA KOMEMORATIVNE SEDNICE POVODOM SMRTI POSLANICE
NEKIBE KELMENDI , ODRŽANE 20. JUNA 2011. GODINE**

**QERSHOR – JUNI
2011**

E hënë, 20.06. 2011,

Drejtton mbledhjen: Kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
E nderuara familja Kelmendi,
Të nderuar mysafirë,
Zonja dhe zotërinj,
Hapi seancën komemorative për nderë të deputetes së ndjerë Nekibe Kelmendi.
Ju ftoj për një minutë heshtje.

(Një minutë heshtje)

Nderimi qoftë me të ndjerën!

Kuvendi i Kosovës ka humbur njërën nga deputetet e tij veterane, zonjën Nekibe Kelmendi. Kësaj radhe, nga sot Kuvendit do t'i mungojë fjala e urtë e Nekibe Kelmendit. Ajo shkoi në amshim, pa mbaruar jo vetëm mandatin që ia dhanë zgjedhësit, si përfaqësuese e tyre, pa i mbaruar angazhimet, por edhe pa e mbaruar jetën.

Nekibe Kelmendi do të kujtohet për kontributin që ka lënë në shumë fusha të angazhimit të saj jetësor. Kontribuoi shumë në fushën e drejtësisë, ku një angazhim të veçantë pati në fushën e të drejtave të njeriut. Do të mbahet në mend si njeri, së nënë, si bashkëshorte që dhimbjen e madhe njerëzore kërkoi ta mund me angazhim të përditshëm për vendin dhe familjen e saj.

Në kohë tepër të vështira të represionit në stil të gjerë që po ushtrhej në Kosovë, Nekibe Kelmendi bashkë me të shoqin, Bajram Kelmendin, mbronin të drejtat individuale dhe kolektive të qytetarëve tanë dhe bënë në njohur gjithandej në botë, në botën demokratike gjendjen e rëndë pas suprimimit të autonomisë së vendit tonë, më 1989.

Paralelisht me punën që bënte për Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, Nekibe Kelmendi nëpërmjet Lidhjes Demokratike të Kosovës, si bashkëthemeluese e saj, u bë pjesë e lëvizjes paqësore, gjyqtare kundër pushtimit të Kosovës.

Pas çlirimit të Kosovës, Nekibe Kelmendi, qysh në administratën e përbashkët me ministrin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë, UNMIK-un, u vu në shërbim dhe në drejtim të vendosjes së themeleve të sistemit të drejtësisë sonë moderne dhe të pavarur. Punoi me përkushtim e profesionalizëm si eksperte Grupit të Unitetit gjatë bisedimeve të Vjenës e më pastaj si bashkëdrejtuese në Komisionin Kushtetues për hartimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Në funksion të drejtësisë, më vonë pas shpalljes së pavarësisë, ajo ushtroi detyrën e ministres së Drejtësisë në Qeverinë e Kosovës.

Nekibe Kelmendi, jetën e saj e mbylli denjësisht si përfaqësuese e zgjedhur e qytetarëve në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Kudo ku angazhohej Nekibe Kelmendi, shquhej për personalizimin e saj, për qëndrimin parimor dhe për vullnetin e saj të hekurt.

Kuvendi i Kosovës i është mirënjohës Nekibe Kelmendit për gjithë kontributin që i ka lënë trashëgim.

I përjetshëm qoftë kujtimi për kolegen tonë, Nekibe Kelmendi!
Faleminderit!

Me një fjalë rasti do të prezantohet në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputeti Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: I nderuar kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Krasniqi,
I nderuar kryeministër, zotni Hashim Thaçi,
Kolegë deputetë të nderuar,
Zonja dhe zotërinj,
Familje shumë e nderuar Kelmendi,
Qytetarë të nderuar të Kosovës,

Me dhembje të madhe po ndahemi sot nga gruaja e madhe e Kosovës – zonja Nekibe Kelmendi.

Zonja Nekibe Kelmendi, themeluese dhe drejtuese e lartë e LDK-së, si dhe deputete në të gjitha legjislaturat e Kuvendit të Republikës së Kosovës, i ka përmasat e personalitetit politik rugovian.

Kjo nënkupton filozofinë nacionale, politike dhe humane. Të gjitha këto të synuara dhe të arritura duke u prirë nga pajtimi kombëtar, solidariteti njerëzor, urtësia politike dhe qëndrueshmëria drejt qëllimit për lirinë, pavarësinë dhe demokracinë e Kosovës.

Në këtë udhë të vështirë prej dy deceniesh, ajo mbeti si bashkëpunëtore dhe bashkudhëtare e palëkundur e Ibrahim Rugovës. Puna për Kosovën, shkuarja e saj dhe mirasi i politikës së saj, e bëjnë kaq të ngjashme me presidentin tonë historik.

Nekibe Kelmendi, punoi për pajtimet shqiptare, si kusht themelor për veprim unik politik.

Nekibe Kelmendi, filozofinë e të drejtave të njeriut, si filozofi universale – punoi për ta bërë vepër në botën shqiptare të Kosovës.

Nekibe Kelmendi, punoi për të ndërtuar institucione demokratike, si domosdo e mbrojtjes institucionale të Kosovës dhe të barazisë së njerëzve të saj.

Zonja Nekibe Kelmendi u bë avokate mbrojtëse e të drejtave njerëzore, e të drejtave nacionale të shqiptarëve.

Nekibe Kelmendi u zgjodh me vota të drejtpërdrejta të qytetarëve, si përfaqësuese në të gjitha legjislaturat e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Një qift i jashtëzakonshëm, bashkë me burrin e vet, zotni Bajram Kelmendin, denoncoi para vendit e para botës gjenocidin serb mbi Kosovën dhe hartoi akuzën kundër Serbisë e Millosheviqit në Hagë.

Ky ishte veprim që parashihte hakmarrjen e egër të kundërshtarit, duke parakuptuar një flijim familjar.

Burri dhe djemtë e Nekibes u ekzekutuan dhe u flijuan për Kosovën, kurse zonja Nekibe e Kosovës nuk ra, por qëndroi për të fituar lirinë e vendit të saj.

Ajo punoi me energji të jashtëzakonshme për lirinë dhe pavarësinë e vendit. U bë përfaqësuese ekselente e popullit të vet, legjislatore e pashoqe, duke punuar edhe në hartimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Ajo u bë edhe ministre e Qeverisë së Republikës së Kosovës së pavarur. Nekibja e dinte që dashuria e madhe zakonisht mbaron në dhembje, që idealet e mëdha paguhen me sakrificë, por ajo nuk hoqi dorë për asnjë moment nga filozofia themelore rugoviane për urtësi, qëndrueshmëri e dinjitet.

Zonja Nekibe Kelmendi ka krijuar një trashëgimi politike humane, që mbetet vlerë për këtë vend dhe për këta qytetarë. Një krua i gjallë për vlera dhe për njerëzit që do të vijnë pas nesh.

Ne jemi edhe të privilegjuar dhe krenarë që kemi pasur rastin e fatin të bashkëpunojmë me një grua e personalitet deri në frymën e saj të fundit, që e kishte dhe që e dha për Kosovën.

Lavdi atyre që jetojnë gjithmonë! Nekibe Kelmendi do të jetojë përherë në Kosovë e ndër shqiptarë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar kryeministër,
Ministra të kabinetit qeveritar,
Të nderuar mysafirë,
Këshilli organizativ në hollin e Kuvendit ka organizuar nderim para arkivolit të deputetes së ndjerë, Nekibe Kelmendi.
Me këtë mbyllim seancën komemorative.

Përgatiti:

Njësia për Transkriptim dhe Lekturë e Kuvendit të Kosovës